



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk & “G.P.G. COMPANY” shpk & “ALBA KONSTRUKSION” & “VEKO” shpk;

Adresa: Njesia Administrative nr.7, Rruga Frederik Shiroka, Ndertesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 6, Tiranë, dhe Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut, Lushnje

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” me objekt “Rikonceptimi i kopshtit zoologjik”.

Numri i referencës së procedurës/lotit REF-50868-02-18-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikonceptimi i kopshtit zoologjik”.

Fondi limit: 702,223,384.20 (shtatëqind e dy milion e dyqind e njëzet e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzet) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 18.05.2020, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 7 datë 24.02.2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ELDA-VL” Shpk; NUIS K67106202W

Vlera e ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk & “G.P.G. COMPANY” shpk & “ALBA KONSTRUKSION” & “VEKO” shpk;

NUIS K61625001I, NUIS J61812013R, NUIS K12511628P, NUIS J64324443V

Vlera e ofertës = 617,567,374.71 (gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e një) lekë pa

3. Operatori ekonomik “Agi Kons” shpk

NUIS K21622001M

Vlera e ofertës = 666,709,645 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e nëntë mijë gjashtëqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “ ELDA-VL” Shpk;

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Elda -VL” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik vetëm Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.

Mungesa e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Agi Kons” shpk ;

- Operatori ekonomik “Agi kons” shpk nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të Dokumenteve Standarte të Tenderit “*Operatori Ekonomik duhet të disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme...*” pasi nuk zotëron nënkategoritë e pikave të licensës, konkretisht NP-9-D e ka NP-9-C; NP-12-F e ka NP-12-A pra nuk janë nënkategoritë e kërkuara.
- Operatori ekonomik “Agi kons” shpk nuk përmbush pikën e mësipërme pasi në Licensën e zbatimit të punimeve me NZ. 4194/12 nuk posedon kategorinë N.S–15 D (Pastrim i ujërave detare, liqenore dhe lumore).
- Operatori ekonomik “Agi kons” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën PASS 99-2012 cka bie në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar në germën “e” të pikës 11 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Çertifikatën e sigurisë së trafikut rrugor PASS 99-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes*”.
- Operatori ekonomik “Agi kons” shpk nuk përmbush pikën 12 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të Dokumenteve Standarte të Tenderit duke mos paraqitur License lidhur me ndikimin në mjedis Kodi III.2.A leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit.
- Operatori ekonomik “Agi kons” shpk nuk ka paraqitur autorizim per lëndën drusore cka bie në kundërshtim me pikën 14 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të kualifikimit të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim per lëndën drusore që do përdoret për binarët e drurit, të përcaktuar në pikën 11.1 germa.a të Specifikimeve teknike, nga prodhuesi ose nga distributori i*

autorizuar për këtë procedurë prokurimi. Prodhuesi ose distributori duhet të ketë certifikim të materialit të drurit sipas standartit EN 14081. Në autorizim të përcaktohen dhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana jonë. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vertetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit”.

- Operatori ekonomik “Agi kons” shpk nuk plotëson pikën 15 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi nuk ka deklaruar në Shtojcën 10 mjete e kërkuara: kamion me kapacitet mbajtës 10-15 ton, 4 copë dhe kamioncina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton , 5 copë;
- Në Shtojcën 10 është deklaruar vetëm 1 nga 4 eskavatorë me goma të kërkuar cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 15 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit.
- Nga 3 fadroma me goma të paraqitura vetëm për 2 është paraqitur dokumentacioni i kërkuar ndërsa fadroma me targë JCB 3CX është deklaruar dhe paraqitur vetëm me faturë tatimore pa dokumentacionin e kërkuar cka bie në kundërshtim me gërmën “a” të pikës 15 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme)”*.
- Nuk janë deklaruar në shtojcën 10 mjetet e kërkuara: Grejder, Asfaltoshtuese, Traktor bujqësor për gjelbërim, Autobitumatriçe dhe Makineri për vijëzim me bojë bikomponente duke mos përmbushur kërkesat e pikës 15 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”*.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Bashkimi i Operatorëve ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk & “G.P.G. COMPANY” shpk & “ALBA KONSTRUKSION” & “VEKO” shpk me adresë: Njesia Administrative nr.7, Rruga Frederik Shiroka, Ndertesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 6, Tiranë, dhe Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut, Lushnje se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 617,567,374.71 (gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 21.05.2020

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk u paraqitur asnjë ankesë.

